



**FONDI SHQIPTAR
I ZHVILLIMIT**

Tiranë, më 07/04/2022

Terma Reference

“Studim fillestar (baseline study) mbi vlerësimin e impaktit të Programit 100 Fshatrat”.

1. Hyrje

Programi Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe të Integruar në “100 Fshatrat”, është një program i Qeverisë Shqiptare i nisur në vitin 2018 që përfaqëson një nismë të zhvillimit ekonomik rural dhe synon të koordinojë të gjitha nismat sektoriale në një program të integruar në nivel rajonal.

Fshati shqiptar, në 100 vitet e fundit ka kaluar nëpër disa periudha zhvillimi duke lënë gjurmë në (nën)zhvillimin e fshatit. Në ditët e sotme është rritur interesi për eksplorimin e mëtejshëm të potencialeve dhe zhvillimin e këtyre zonave. Këtë e dëshmon interesimi i vendasve dhe emigrantëve për të investuar në këto zona, si dhe interesi i treguar nga turistët vendas dhe të huaj për të vizituar këto fshatra si destinacione turistike, duke ringjallur kështu ekonominë rurale përtej sektorit bujqësor.

Në këtë kuadër, Programi 100 Fshatrat synon, ndër të tjera, të bashkërendojë ndërhyrjet zhvillimore në këto zona, bazuar në një qasje ndërsektoriale me shumë aktorë, duke u larguar nga ndërhyrjet e fragmentuara dhe qasja rreptësisht sektoriale. Si i tillë, Programi mishëron një qasje nga poshtë-lart bazuar në identifikimin e nevojave dhe potencialeve të ofruara nga konteksti lokal në fshatra në njërin anë dhe një qasje më rajonale, duke u mbështetur në potencialet komplementare të ofruara, në një shkallë më të gjere, të këtyre territoreve, si pjesë e 100 fshatrave.

Programi për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe të Integruar "100 + Fshatrat", është një program 8-vjeçar i ndarë në dy faza kryesore siç tregohet më poshtë:

Faza I, me një hark kohor prej 3 vitesh (2021 – 2024), financohet nga QSH e cila do të:

- Ndërtojë një sistem më efikas për funksionimin e programit;
- Testojë qasjen e integruar të ndërhyrjeve nëpërmjet financimit të bllokut të parë të projekteve në territor;

Faza II, do të mbulojë periudhën 2024 - 2027 dhe përkon me zbatimin e ndërhyrjeve të tjera prioritare të identifikuara. Gjatë kësaj faze parashikohet që kontributit financiar të Qeverisë së Shqipërisë t'i bashkohen edhe donatorë të tjerë, institucione financiare ndërkombëtare dhe banka zhvillimore.

Sipas dispozitave ligjore, FSHZH është përgjegjëse për administrimin, koordinimin, monitorimin dhe vlerësimin e Programit.

2. Konteksti dhe Objektivi i Përgjithshëm

Nxitja e një zhvillimi të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm social dhe ekonomik, duke u mbështetur në karakteristikat dhe tiparet e rajoneve të ndryshme, duke ruajtur dhe zhvilluar veçoritë e tyre natyrore dhe kulturore, duke nxitur potencialet e tyre zhvillimore ekonomike dhe duke ofruar kushte më të mira sociale dhe ekonomike për qytetarët shqiptarë, është synimi i përgjithshëm i Reformës së Zhvillimit Rajonal në Shqipëri, prioritet kombëtar i Qeverisë Shqiptare, i rregulluar në bazë të Ligjit nr. 102/2020 “Për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin”.

Zyra e Zëvendëskryeministrit, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, mbështetur nga qeveritë e Konfederatës Zvicerane dhe të Austrisë - nëpërmjet Programit të Zhvillimit Rajonal në Shqipëri (projekti RDPA) - janë ngarkuar me objektiva specifike për të cuar përpara reformën.

Në këtë kontekst, duke pasur parasysh rëndësinë e Programit 100 Fshatrat, shtrirjen dhe kontributin e tij në Reformën e Zhvillimit Rajonal në Shqipëri dhe ndikimin e pritshëm të tij në jetën social-ekonomike të banorëve të saj, në ekonominë rurale në përgjithësi dhe në zhvillimin e turizmit në veçanti, FSHZH, e mbështetur nga Programi i Zhvillimit Rajonal në Shqipëri (RDPA) ka vendosur të ndërmarrë një **“Studim fillestar (baseline study) mbi vlerësimin e impaktit të Programit 100 Fshatrat”**.

Objektivi i përgjithshëm i kësaj detyre është përcaktimi dhe zhvillimi i Metodologjisë për Studimin e Vlerësimit të Impaktit, në kuadër të Programit 100 Fshatrat dhe të kryejë një Studim fillestar si pjesë e Vlerësimit të impaktit.

2.1. Objektivat specifike dhe produktet kryesore që synon të realizojë studimi fillestar (baseline study) për Vlerësimin e Impaktit të Programit 100 F

Studimi i Vlerësimit të Impaktit do të ofrojë informacion të besueshëm dhe të dobishëm në lidhje me zbatimin e përgjithshëm të programit dhe arritjen e Objektivave dhe Rezultateve të Zhvillimit të Programit.

Për ta arritur këtë, duhet të zhvillohen sa vijon:

A: Metodologjia e detajuar e vlerësimit dhe përcaktimi i mjeteve të nevojshme

Metodologjia duhet të përfshijë dy faza studimin fillestar (baseline study) dhe vazhdimin (follow up) dhe do të bazohet në dy mjete kryesore, por pa u kufizuar në to:

- Mbledhja e të dhënave parësore nëpërmjet anketave në terren (një kombinim i anketave dhe/ose pyetësorëve; diskutime dhe vlerësime në fokus grupe);
- Mbledhja dhe analiza e të dhënave dytësore;

Audienca e synuar që duhet mbajtur parasysh gjatë hartimit të metodologjisë

- Popullsia (familjet) rezidente në zonat e synuara;
- Turistët;
- Bizneset;
- NJQV-të;

B: Studimi fillestar (baseline study), që përfshin zhvillimin e anketës në terren, plotësimin e pyetësorëve, ngritjen e bazës së të dhënave, përpunimin e të dhënave dhe nxjerrjen e rezultateve, përgatitjen dhe dorëzimin e raportit të gjetjeve të studimit).

Hapat e mëposhtëm do të merren parasysh gjatë përfundimit të detyrave:

Mbledhja dhe analizimi të dhënave parësore përfshin tre detyra kryesore:

- (i) një anketë përfaqësuese e familjeve në secilin prej grupeve të përzgjedhura, pjesë e programit të 100 fshatrave. Lista e vendndodhjeve të përzgjedhura mund të shtohet ose zvogëlohet, rast pas rasti, në konsultim me FSHZH;
- (ii) një anketë përfaqësuese e bizneseve (formale dhe joformale) (përfshirë strukturat e akomodimit, shtëpitë e pritjes, hotelet, restorantet, fermat, bizneset bujqësore, artizanatin, bimët mjekësore, etj.) në secilin prej vendndodhjeve të përzgjedhura;
- (iii) një anketë e turistëve në secilin prej vendndodhjeve të përzgjedhura;

Detyrat (i) dhe (ii) synojnë të japin të dhëna nëse familjet dhe bizneset mund të përfitojnë nga investimet e bëra në kuadër të Programit 100 Fshatrat, me fokus në potencialin njerëzor, mjedisor, ekonomik dhe social, zhvillimet e qeverisjes, etj.

Detyra (iii) synon të ofrojë një fokus të veçantë në përdorimin dhe kënaqësinë e turistëve me shërbimet dhe infrastrukturën private dhe publike, dhe të vlerësojë modelin e përgjithshëm të shpenzimeve dhe qëndrimit gjatë vizitës së tyre - gjë që do të lejojë të vlerësimin e ndikimit ekonomik të programit.

Mbledhja dhe analizimi i të dhënave dytësore që lidhen drejtpërdrejt me: (por pa u kufizuar vetem në to):

- rritja e numrit të turistëve;
- trendi i papunësisë dhe punësimit para, gjatë dhe pas përfundimit të programit;
- krijimi i vendeve të reja të punës;
- zvogëlimi i numrit të familjeve që jetojnë nën kufirin e varfërisë;
- zgjatja e qëndrimit, rritja e shpenzimeve nga vizitorët,
- Rritja e numrit të bizneseve;
- rritje të të ardhurave për bizneset, etj.;

Zona e mbulimit shtrihet në territorin e 100+ fshatrave, në të gjithë territorin e vendit, dhe do të synojë mbulimin e plotë të saj në formën e grup-fshatrave/dhe, kur është e mundur, në nivel fshati.

2.2. Detyra specifike që parashikohet të kryhen në kuadër të këtij vlerësimi

Detyra 1 - Përcaktimi dhe zhvillimi i metodologjisë e vlerësimit.

- Përcaktimi i qasjes metodologjike, duke përfshirë mbulimin gjeografik të anketimit në çdo zonë/grup; teknikat e kampionimit dhe anketimit për secilin nga anketat - duke

përfshirë mekanizmat e kontrollit të cilësisë. Metodologjia duhet të jetë një qasje pre-post (para-pas), në mënyrë që të merret një efekt i qartë dhe maksimal i projektit;

- Konfirmimi i madhësisë së kampionit, duke përdorur metoda statistikore (llogaritjet e fuqisë- Power calculations), që duhet të mbulohen për të paktën 3 anketa për t'u siguruar që ato janë statistiki të sakta dhe të besueshme;
- Përgatitja e draft instrumenteve të anketimit dhe Diskutimit ne Grupeve të Fokusuara dhe finalizimi i pyetësorëve bazuar në komentet e marra gjatë testimit;
- Trajnimi për intervistuesit për studimin fillestar (baseline study) të fazës 1. Trajnimi duhet të bëhet pasi instrumenti të jetë kolauduar. Intervistuesit duhet të asistohen në të gjitha seancat e trajnimit në mënyrë që të jenë në gjendje të fillojnë kryerjen e anketës. Duhet të identifikohet një proces kontrolli i cilësisë, duke përfshirë disa filtra që do të përdoren gjatë mbledhjes së të dhënave për të siguruar cilësi maksimale.

Detyra 2 - Anketa 1: Anketa e Familjeve

Një anketë e familjeve (Household Survey) pritet të kryhet me anë të intervistave ballë për ballë. Një ushtrim listimi duhet të kryhet në çdo lokacion, duke mbledhur totalët e popullsisë së targetuar, në çdo grup të përzgjedhur, me qëllim të rregullimit të peshës.

Studimi duhet të japë të dhëna cilësore dhe sasiore - ndër të tjera - për:

- Përmirësimin (nëse kjo ka ndodhur) e kushteve të jetesës së popullatës përfituese;
- Rritjen (nëse kjo ka ndodhur) e të ardhurave për popullsinë vendase;
- Aksesin në shërbimet publike/infrastrukturë/hapësirat publike në lidhje me projektin;
- Nivelin e kenaqësisë në lidhje me shërbimet publike/infrastrukturën/hapësirat publike;
- Karakteristikat e banesave, vlera dhe përdorimi (p.sh. qiraja, etj);
- Tregun e punës, veçanërisht punësimi i lidhur me sektorin e turizmit, duke përfshirë aktivitetet e brendshme;

Sa poshtë duhet të zhvillohet si pjesë e Detyrës 2:

- (i) Zhvillimi i Anketës së Familjeve;
- (ii) Pastrimi i të dhënave dhe sigurimi i cilësisë dhe ndërtimi i bazës së të dhënave;

Detyra 3 - Anketa 2: Anketa e Biznesit

Në kuadër të këtij studimi parashikohet të kryhet një anketim i bizneseve. Madhësia totale e kampionit duhet të jetë përfaqësuese duke përfshirë bizneset joformale dhe formale në secilën prej vendndodhjeve të përzgjedhura. Më shumë fokus do t'u kushtohet bizneseve të lidhura me turizmin, atyre që merren me ofrimin e mallrave dhe/ose shërbimeve direkt për turistët dhe bizneset që u shërbejnë turistëve (p.sh. hotelet, furnitorët e tyre, akomodimet e tjera, operatorët turistikë, agjencitë e udhëtimit, restorantet dhe baret/kafetë, ofruesit e shërbimit taksit dhe transportit, shitjet me pakicë të artit dhe artizanateve, pika të tjera të shitjes me pakicë të përdorura nga turistët).

Anketa 2 duhet të japë të dhëna cilësore dhe sasiore - ndër të tjera - për:

- Aksesin në (shërbimet/infrastrukturën e projektit);
- Nivelin e kënaqësisë lidhur me shërbimet/ndërhyrjet e projektit;

- Rritjen e biznesit;
- Rritjen e të ardhurave për bizneset (nëse kjo ka ndodhur) ;
- Punësimin;
- Mjedisin e biznesit lokal, etj;

Detyra 4 - Anketa 3: Anketa e Turistëve

Një anketim i turistëve në vendet e përzgjedhura pritet të kryhet me anë të intervistave ballë për ballë dhe regjistrimit të vendndodhjes GPS. Ky sondazh duhet të kryhet në muajt e verës, për t'u siguruar që ai të kapë kulmin e sezonit turistik. Procedura e përzgjedhjes rastësore për intervistimin e turistëve duhet të specifikohet si pjesë e raportit metodologjik. Intervistat duhet të shpërndahen: (i) në ditë të ndryshme të javës; (ii) në kohë të ndryshme gjatë ditës.

Intervistat duhet të zgjasin jo më shumë se 10-15 minuta dhe gjithashtu duhet të japin të dhëna cilësore dhe sasiore - ndër të tjera - për:

- Informacionin dhe procesin e rezervimit;
 - Kohëzgjatjen e vizitës, vendin e qëndrimit dhe mjetet e transportit;
 - Sitet/vendet e vizituara gjatë qëndrimit;
 - Shumën e detajuar të shpenzuar gjatë vizitës;
 - Pritshmërinë dhe nivelin e kënaqësisë për një sërë atributësh, duke përfshirë vendet turistike, akomodimin, ushqimin, aksesin, transportin për në destinacion dhe transportin në brendësi të destinacionit, infrastrukturën urbane, nivelin e cmimeve, trashëgiminë kulturore, etj.
- (i) Anketa me turistët do të kryhet me intervista ballë për ballë. Instrumenti i anketimit duhet të kryhet në shqip ose anglisht, ose të përshtatet me gjuhën e turistit të përzgjedhur. Përveç kësaj, mekanizmat e kontrollit të cilësisë duhet të vendosen për të vlerësuar nëse intervistuesit po kryejnë saktë anketimin dhe të merren masa për të shqyrtuar dhe korrigjuar çdo gabim.
- (ii) Pastrimi i të dhënave, Sigurimi i cilësisë dhe ngritja e bazës së të dhënave: Të dhënat do të integrohen në një bazë të dhënash dhe do të kontrollohen për konsistencë logjike, modele të kapërcimit (skip patterns) dhe variabla të papranueshëm ose jashtë vargut (out of range).

Detyra 5 - Fokus grupet

Për të plotësuar dhe pasuruar opinionet e marra nga intervistat, do të organizohen diskutime në grupe të fokusuara për të dhënë informacion shtesë për disa çështje që lidhen me programin dhe ndikimin e tij në jetën e përfituesve dhe grupeve të synuara. Fokus grupet do të synojnë të bashkojnë familjet, bizneset, autoritetet vendore dhe subjekte të tjera të gjykuara se mund të japin opinion. Në këtë kontekst duhet të përgatitet një udhëzues specifik për të moderuar dhe për t'i dhënë orientim diskutimit.

Detyra 6 - Mbledhja e të dhënave dytësore

Veçanërisht si pjesë e punës së Ekspertit të Zhvillimit Ekonomik dhe Ekspertit të Analizës së të Dhënave, të dhënat dytësore që do të identifikohen, mblidhen dhe vlerësohen duhet të lidhen me temat e mëposhtme:

- rritjen e numrit të turistëve;
- trendin e punësimit dhe i papunësisë para, gjatë dhe pas përfundimit të projektit;
- krijimin e vendeve të reja të punës;
- zvogëlimin e numrit të familjeve që jetojnë nën kufirin e varfërisë;
- zgjatjen e qëndrimit, rritjen e shpenzimeve nga vizitorët;
- Rritjen e numrit të bizneseve;
- Rritjen e të ardhurave për bizneset etj.

Detyra 7 - Përgatitja e Raportit të Gjetjeve të Studimit Fillestar (Baseline Study)

Në kuadër të kësaj kontrate do të përgatitet Raporti i Gjetjeve të Studimit Fillestar (Baseline Study), i cili do të përmbajë gjetjet kryesore të studimit. Raporti do të jetë analitik dhe do të kombinojë të dhënat parësore dhe dytësore të mbledhura gjatë detyrës. Raporti do të përdorë metoda të përshtatshme sasiore dhe cilësore për analizën e të dhënave dhe gjithashtu duhet të përfshijë një përmbledhje të gjetjeve nga diskutimet e fokus grupeve.

Raporti do të dorëzohet në format elektronik, plus 2 kopje të printuara, njëra në shqip dhe tjetra në anglisht. Koha e dorëzimit të raportit do të jetë 1 muaj pas përfundimit të intervistave në terren (tetor 2022). Raporti do të konsiderohet i përfunduar pas miratimit nga FSHZH. Raporti përfundimtar do të jetë i dizajnuar mirë grafikisht dhe i gatshëm për printim dhe botim.

3. Raportet dhe skeduli i produkteve

Tabela e mëposhtme përmbledh produktet dhe kohën e dorëzimit të tyre:

Produktet	Koha
Produkti 1 - Metodologjia, të miratohet nga FSHZH përpara fillimit të punës	Java e tretë e muajit të parë të ofrimit të shërbimit
Produkti 2 - Përgatitja dhe testimi i draft pyetësorëve të anketimit të ekonomive familjare, anketave të biznesit dhe turizmit dhe FDG-ve, që do t'i dorëzohen FSHZH-së për miratim përpara fillimit të punës në terren.	Tre javë pas miratimit të Raportit Fillestar dhe metodologjisë
Produkti 3 - Anketimi i Familjeve (Households Survey)	Tetë - dymbëdhjetë javë pas miratimit të FG-ve dhe anketës testuese
Produkti 4 - Anketimi i Biznesit (Business Survey)	
Produkti 5 - Anketimi i Turistëve (Tourist survey)	
Produkti 6 - Diskutimi në Fokus Grupe	2-3 jave pas anketave në terren
Produkti 6 - Draft Raporti i Studimit Fillestar të Gjetjeve të Vlerësimit të Impaktit	Dy javë pas sondazhit në terren dhe FG-ve
Produkti 7 - Raporti i Studimit Fillestar të Gjetjeve të Vlerësimit të Impaktit	Dy javë pas komenteve mbi draft raportin dhe draft publikimin

4. Koordinimi me punëdhënësin, autoritetet qendrore dhe vendore

Konsulenti do të kontraktohet nga Programi i Zhvillimit Rajonal në Shqipëri (RDPA) dhe do të punojë nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të FSHZH-së, për të menaxhuar dhe realizuar detyrën.

Eksperti do të ofrojë përditësime/raporte javore mbi ecurinë e progresit të mbledhjes së të dhënave gjatë kryerjes së tre anketave, duke përfshirë tabelat e përzgjedhura të rezultateve, në shqip dhe në anglisht.

Gjatë përfundimit të detyrave mund të zhvillohen disa procese konsultimi, duke patur parasysh se pjesë e këtyre konsultimeve mund të jenë edhe institucione, agjenci apo subjekte të tjera shtetërore përkatëse të konsideruara si të rëndësishme për këtë studim.

Në nivel lokal, eksperti do të bashkëpunojë ngushtë me autoritetet përkatëse vendore, të cilët janë përfituesit e drejtpërdrejtë të programit.

5. Kohëzgjatja e kontratës dhe Termat e pagesës

Detyra parashikohet të përfundojë brenda **7 (shtatë) muajve**, nga data e nënshkrimit të kontratës. Koha e parashikuar e fillimit të shërbimeve është Maj 2022. Kontrata pritët të përfundojë deri më 30 nëntor 2022.

Konsulenti do të paguhet individualisht nga programi RDPA, megjithëse ai do t'i raportojë kryesisht FSHZH-së.

Njoftim i rëndësishëm: Duke qenë se për kryerjen e këtij studimi do të angazhohen dhe konsulentë të tjerë që do të mbulojnë pozicione dhe detyra të tjera komplementare të nevojshme për kryerjen e këtij studimi, lejohet angazhimi i konsulentëve individualë që në aktivitetin e tyre të përditshëm mund të jenë pjesë e së njëjtës kompanie.